



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 27-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.06.2024, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Semetishti, DUMB
2. Shkelzen Hajdini, DSHMS
3. Latif Ramadani, DBF

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë, pastaj tha e keni edhe një pike shtese te cilën e keni pranuar përmes emailit po ashtu edhe ne mënyrë fizike tani dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 26-të e KPF-së
2. Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
3. Propozim Vendim mbi rialokimin e mjeteve buxhetore të mbetura nga të hyrat vetanake.
4. Informatë lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031.
5. Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Lipjanit 2024-2027.
7. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
8. Propozim venim për aprovimin e rezervës komunale 2024

Pastaj Kryesuesi tha sa e keni vërejtje apo plotësime rreth rendit te ditës

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës me pikës shtese dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi rendin e ditës:

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 26-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 26-të të KPF-së

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pikat tjera te rendit te ditës.

II

Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadasnit, drejtor i DBF-së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, a u sqarua pune e qasje qe do te kenë zvogëlim te stafit ne shëndetësi dhe arsim a jo?

Latif Ramadani, ajo sqarohen ne kornizën e dyte buxhetore, po shpresojmë qe është gabim teknik.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim mbi rialokimin e mjeteve buxhetore të mbetura nga të hyrat vetanake.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadani DBF, i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

IV

Informatë lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit DPUMM i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se Hartën zonale janë ende ne fuqi dhe nuk mund te behet diçka e tille qe është ne kundërshtim me hartat zonale. Unë jam i mendimit me mire te anulohet plani zhvillimor komunal e sa te behet një deponi e tillë.

Alban Salihu, tha se deponia duhet ti plotësoj kriteret ligjore qe te behet.

Egzona Bytyqi, tha se unë jam kundër qe kjo deponi te behet aty dhe duhet te shfrytëzohen te gjithë mekanizmat ligjor qe ajo mos te behet aty, pasi qe do ta shkaktonte shume problem për banorët e asaj pjese.

Imri Semetishti, tha se ne e kemi kundërshtuar me te gjitha mënyrat ligjore dhe nuk do te lejojmë qe te behet një deponi e tille.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës 2024-2026.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit DA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se a do te paguhet kjo ekipe pasi qe është edhe një detyre shtese për ta. Dhe e dyta pse nuk janë hy edhe sanksionet ne këtë plan.

Rasim Hasani, tha se po kemi vështirë ti paguajmë, ndërsa sa i përket sanksioneve i kane ne ligj.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim për miratimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Komunën e Lipjanit 2024-2027.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit, DSHPS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se një strategji shume e mire ku janë përfshire dhe grupet me te marginalizuara edhe një nisme e tille shume e mirëpritur.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve – Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdini DSHPS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se duhet te rritet shuma apsi qe nuk është e mjaftueshme kjo shumë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

VIII

Propozim venim për aprovimin e rezervës komunale 2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit DSHPS i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë vota për, aprovoi propozimin

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi